

## KOÇO BIHIKU

MBI ROLIN E LUFTËS NACIONALÇLIRIMTARE PËR ZHVILLIMIN  
E LETËRSISË SHQIPTARE

Problemi i rolit që luajti Lufta nacionalçlirimtare në zhvillimin e letërsisë shqiptare pothuajse nuk është studjuar. Për rëndësinë e kësaj ngjarje historike në jetën e letërsisë është folur kalimthi në artikuj përkujtimorë ose në referate, kushtuar zhvillimit të letërsisë së sotme.<sup>1</sup> Sqarimi i problemit të ndikimit që pati lëvizja revolucionare antifashiste për procesin historiko-letrar ka rëndësi, sepse lidhet me ndriçimin e një varg problemesh të historisë së letërsisë së re shqiptare.

Lufta nacionalçlirimtare ishte një ngjarje me rëndësi të madhe historike në jetën e vendit. Ajo ndryshonte nga lëvizjet e mëparshme çlirimtare jo vetëm nga përpjestimet e gjëra që mori dhe nga vetëdija e lartë politike e masave, por — dhe kjo ishte themelore — nga rezultatet që arriti. Përmbajtja kryesore e saj ishte zhdukja e skllavërisë fashiste, përmbysja e klasave të vjetra sunduese, që u bashkuan me pushtuesit e huaj dhe vendosja e pushtetit të popullit. Rëndësia historike e kësaj ngjarjeje është përcaktuar qartë nga shoku Enver Hoxha, i cili ka thënë:

«Lufta nacionalçlirimtare është shfaqja më e ndritur e historisë së popullit tonë shqiptar, pse ajo çliroi njëkohësisht atdheun nga zgjedha e okupatorëve fashistë, dërmoi përgjithmonë klasat sunduese feudalo-borgjeze, i dha pushtetin popullit»<sup>2</sup>.

Si ngjarje që shënoi kthesë rrënjësore në jetën historike të popullit shqiptar, Lufta nacionalçlirimtare pati një ndikim të thellë në zhvillimin e letërsisë; ajo përcaktoi dukjen e elementeve të reja, të cilat e ndryshuan drejtimin e procesit letrar.

Për të sqaruar në mënyrë sa më të plotë se ç'rëndësi pati Lufta nacionalçlirimtare për letërsinë shqiptare, duhet të kemi parasysh se si u zhvillua kjo nga fillimi i viteve 20 deri më 7 prill 1939, çfarë veçorish e karakterizuan procesin historiko-letrar.

Siç dihet, kur shpërtheu lëvizja çlirimtare antifashiste, letërsia ishte në gjendje të vështirë. Pushtimi i vendit nga fashistët italianë ngjalli hutim në radhët e autorëve përparimtarë. Duke mos pasur të qartë perspektivën, ata nuk mundën të ndikonin në zhvillimin e ngjar-

1) Shih, Sh. Musaraj, *Dhjetë vjet letërsi nën drejtimin e Partisë*, «Letërsija jonë», 1951, Nr. 10; po ai, *Referat i mbajtur në Konferencën III të Lidhjes së shkrimtarëve të Shqipërisë*, «Konferenca III e Lidhjes së shkrimtarëve të Shqipërisë (9-12 tetor 1944)», T. 1950 etj.

2) E. Hoxha, *Fjalim i mbajtur në mbledhjen solemne me rastin e dhjetëvjetorit të çlirimit*, Tiranë 1954, f. 9.

jeve me anë të fjalës artistike. Për ta ishte karakteristik dëshpërimi, mungesa e besimit në jetë dhe pesimizmi.

Pa dyshim, kjo erdhi sepse letërsia përparimtare nuk arriti të konsolidohet në shkallën e duhur nga pikëpamja ideore dhe artistike. Kjo e fundit nga ana e vet, shpjegohet me faktin, se formimi i rrymës përparimtare në letërsi kaloi një rrugë të vështirë dhe plot pengesa.

Në fillim të viteve 20, pasi u siguria pavarësia kombëtare dhe tërësia tokësore, në letërsi u krijua një gjendje kontradiktore dhe e paqartë, e cila u shkaktua, në radhë të parë, nga kriza e idealeve të Rilindjes. Në këtë kohë doli më qartë dhe më në pah kontradikta midis qëllimeve për të cilat luftuan e dhanë jetën patriotët dhe realitetit të ri shoqëror e politik të Shqipërisë. Për një varg arësyesh, hallkat kryesore të administratës së shtetit të ri shqiptar i shtien në dorë elementë antipatriotë e reaksionarë, ish-memurë të perandorisë otomane, të cilët e kishin luftuar më parë çeshtjen kombëtare, njerëz të pazotë, parazitë e hajdutë. Në këto rrethana u harruan sakrificat e bijve më të mirë të Shqipërisë dhe u braktisën idealet e tyre të larta qytetare. Kjo kontradiktë gjeti pasqyrim në veprat e shkrimtarëve patriotë, të cilët flisnin plot dhembje për humbjen e iluzioneve të patriotëve të ndershëm dhe të masave popullore («Trashëgimi» i Asdrenit, «Naim Frashëri» i L. Poradecit). Të deluzionuar nga kjo gjendje, mjaft shkrimtarë u hodhën ose në të kaluarën historike, a në estetizëm e misticizëm, ose, çka është më keq, u tërhoqën për gjithnjë nga jeta letrare.

Por, krahas kësaj, në letërsinë e kësaj kohe vihen re edhe tendenca të tjera. Vitet, kur merr vrull lëvizja e përgjithshme demokratike, janë periudhë hovi për një palë shkrimtarësh demokratë, si Noli e Asdreni, të cilët shtrojnë dhe rrahin në veprat e tyre problemet aktuale politike e shoqërore, si problemin e gjendjes së shtypur të popullit etj.

Asdreni, që vinte nga gjiri i intelektualëve demokratë mikroborgjëzë, gjithnjë kishte mbajtur anën e vegjëlisë, e cila sipas tij, ishte shtylla e lëvizjes kombëtare. Por, në qoftë se më parë, poeti e kishte shikuar gjendjen e popullit nga pikëpamja abstrakte morale, në fillim të viteve 20, botëkuptimi i tij pëson ndryshime. Në këtë kohë demokratizimi i tij thellohet më tej. Në krijimet e këtyre viteve ai stigmatizon me ashpërsi bejlerët si kriminelë, që shfrytëzojnë pa mëshirë bujqit e varfër. Në këtë periudhë ai shkroi poemthin realist «Burri i dheut»<sup>3</sup> (një nga veprat e rralla që i bënë jehonë luftës së Vlorës), në të cilën konstatoi zgjimin social të vegjëlisë, si fenomen të shënuar për kohën. Kalimi në realizëm shihet edhe në «Fisnikët e Shqipërisë» dhe «Republika shqiptare»<sup>4</sup>, ku Asdreni fshikullon rëndë klasën feudale si shkak-tare e të gjithë të këqijave që po heq populli shqiptar.

Fryma demokratike në letërsi u thellua më tej në veprat e Nolit, i cili e zhvilloi në mënyrë më të hapur dhe më të vendosur luftën kundër bejlerëve dhe forcave të tjera reaksionare, duke e çuar deri në pranimin e revolucionit popullor si mjet për të hequr qafe këta armiq të vegjëlisë. Në këtë mendim Noli erdhi pasi kapërceu pikëpamjet idealiste që kishte për problemin e raportit të masave me individin e shquar dhe për rolin e rëndësishëm e dhunës revolucionare në histori («Marshi i Krishtit», «Marshi i kryqëzimit»). Këto probleme e kishin shqetësuar Nolin që në krye të veprimtarisë së tij si aktivist të lëvizjes kombëtare,

3) Asdreni, *Vepra të zgjedhura*, Tiranë 1958, f. 69.

4) Po aty, f. 83 e 84.

por, pas dështimit të Revolucionit demokratiko-borgjez të qershorit të vitit 1924, poeti ju rikthye këtyre problemeve, duke u nisur nga përvoja e ngjarjeve revolucionare. Duke shqyrtuar problemin e shkaqeve që sollën dështimin e revolucionit, Noli u ndesh sërish me çështjen e rolit të popullit në zhvillimin e ngjarjeve historike, të raportit të masës me individin etj. Në fund të viteve 20, pas kërkimeve ngulmuese për të gjetur rrugët nëpërmjet të cilave do të çlirohej populli nga zgjedha cifligaro-borgjeze, Noli vjen në përfundim, se lëvizja demokratike revolucionare do të ngadhënjë në qoftë se çështja e tij do të bëhet çështja e vegjëlisë së shtypur, e «katundarëve dhe e punëtorëve». Me «Anës lumenjve», që e përshton ideja e revolucionit popullor si rruga e shpëtimit të vegjëlisë, Noli u ngrit në majën më të lartë të krijimtarisë së vet artistike. Kjo vjershë shënon edhe një lartësi të re për letërsinë demokratike dhe për mendimin politik përparimtar të kësaj periudhe historike.

Afirmimi nga Noli i idesë së popullit si forcë historike e pavarur dhe si forcë krijuese ishte i lidhur me stigmatizimin e forcave reaksionare që erdhën në fuqi pas dhjetorit 1924. Tek këta njerëz poeti sheh mishërimin e tradhëtisë, të obskurantizmit dhe të servilizmit anadollak («Kënga e Salep Sulltanit», «Marshi i Barrabajt»). Forcave reaksionare që uzurpuan drejtimin e vendit, Noli u kundërvë udhëheqësit e popullit, të cilët mishëruan në karakterin e tyre virtutet më të larta: ndershmërinë, pastërtinë morale dhe besnikërinë ndaj çështjes së vegjëlisë («Syrgjyn—vdekur», «Shpell e Dragobisë»).

Siç shihet, në vitet 20 në bazën e zhvillimit të mëtejshëm të tendencave dhe të elementeve progresive të letërsisë të Rilindjes kombëtare dhe të afrimit të mëtejshëm me lëvizjen demokratike, kishte nisur formimi i rrymës përparimtare në letërsinë shqiptare. Por duhet theksuar se ky proces eci me ritëm të ngadalshëm dhe me zor. Çështja është se, me ardhjen në fuqi të forcave reaksionare, për letërsinë përparimtare u krijuan kushte jo të favorshme. Për këto shkaqe, veprat që shprehnin idetë e reja u botuan në faqet e shtypit, që dilte jashtë vendit. Vjershat e veta Noli i nxori në shtypin e emigracionit, i cili hynte në Shqipëri ilegalisht. Përveç poemthit «Burri i dheut», Asdreni nuk i botoi vjershat, në të cilat fshikulloi bejlerët dhe forcat e tjera reaksionare. Nga ana tjetër, s'duhet harruar se, pas botimit të poezive «Anës lumenjve» dhe «Rent or Marathonomak», Noli u tërhoq nga veprimtaria letrare, duke mos krijuar asgjë si poet. Në këtë kohë edhe Asdreni e ndërpreu punën e tij letrare krijuese; vëllimi «Psallme murgu», që u botua më 1930, ishte libri i tij i fundit.

Për të sqaruar plotësisht vështirësitë përmes të cilave kalonte procesi i formimit të rrymës demokratike, duhet pasur parasysh fakti, se vitet 20 janë periudha kur formohet edhe letërsia borgjeze reaksionare. Bashkë me shkrimtarët klerikalë katolikë, letrarët borgjezë formojnë kampin reaksionar antipopullor, i cili kishte në dispozicionin e vet revista dhe gazeta të shumta dhe zintë një pozitë mbizotëruese në jetën letrare. Këto rrethana, s'ka dyshim, penguan forcimin e rrymës përparimtare.

Në vitet 30 nis një etapë e re në historinë e letërsisë përparimtare e realiste. Vrulli që mori qëndresa e shtresave popullore kundër monarkisë cifligaro-borgjeze, përhapja e gjerë e ideve demokratike dhe organizimi i shtypit demokratik krijuan kushte më të favorshme për zhvillimin e letërsisë përparimtare. Në radhët e saj vijnë forca të re-

ja letrare, të cilat sollën një brendi të re, ata parashtruan pikëpamje të reja përsa i përket detyrave të letërsisë, në veçanti, dhe thelbit të krijimtarisë letraro-artistike, në përgjithësi. Shkrimtarët përparimtarë e drejtuan shikimin e tyre në gjendjen e shtresave të ulta të shoqërisë, përshkruan pasigurinë dhe varfërinë në të cilën ata rronin, treguan rrjedhimet tragjike të pabarazisë dhe të shtypjes shoqërore tek përfaqësuesit e vegjëlisë. Ata shtruan si detyrë kryesore dhe më të rëndësishme të letërsisë pasqyrimin e jetës plot shqetësime dhe brengë të masave të varfëra. Krahas kësaj, letrarët e rinj ishin për realizmin si metodë krijuese, sepse vetëm një letërsi e mbështetur mbi parimin e pasqyrimin të jetës u përgjigjej kërkesave të reja të kohës.

Tendencat e reja ideore dhe artistike që nisën të bëjnë shteg në letërsi u shfaqën në mënyrë të plotë dhe të qartë në krijimtarinë e Migjenit. Migjenin e shqetësoi problemi i mjerimit dhe i varfërisë të shtresave të ulta. Ai stigmatizoi rreptë shoqërinë çifligaro-borgjeze, dhe shprehu pakënaqësinë e thellë dhe protestën spontane të masave të shfrytëzuara që rronin në kushte shnjerezore.

Syri i Migjenit diktoi mizorinë dhe ftohtësinë e shoqërisë, në të cilën jeta e skamnorëve nuk kishte shumë dallim nga ajo e kafshëve. Nga të gjitha kërkesat dhe nevojat e natyrshme të njeriut, skamnorëve u kishte mbetur vetëm një: të siguronin copën e bukës për të mbajtur gjallë frymën. Por shpesh edhe kafshata e gojës mungonte; atëhere rrojtja ndërrohej në një luftë të vështirë dhe të mundimshme për të mos vdekur urie. «Ka kohë që misri u ka mungue — rrëfen me ironi shkrimtari — kokrrat e fundit të tij i ruejtën për farë. Nesër duhet me i qitë në dhe dhe mandej me pritë deri sa të bahet misri i ri. E për do kohë, misrit kanë me i xanë vendin «qershijat» («Qershijat»). Por ndonjëherë përpjekja për t'u mbajtur në jetë çon në pasoja shumë të dhimbshme. Për të ruajtur nga të ftohtit lopën, burimin kryesor të jetesës, prindërit e varfër bëhen pa dashur kriminelë të fëmisë së vet («Bukuria që vret»). Në shoqërinë çifligaro-borgjeze njerëzit e thjeshtë nuk gjejnë mundësi të vënë në veprim forcën dhe energjitë e tyre. Heroi i skicës «Moll' e ndalueme» bredh tërë ditën nëpër qytet për të gjetur ndonjë punë që të nxjerrë kafshatën e gojës, por askush nuk ka nevojë për krahët e tij, megjithëse është i ri dhe i fuqishëm. «Vazhdon puntori ynë t'u bijë pash më pash rugave të qytetit. Kërkon punë. Si kolegët e tij në Berlin e në London. Askund një karrocë e ngarkueme që ta zhgarkojë ai. Askund udhtar me valixhe në dorë, që t'u ndihmojë. Askund! Askund! S'e do kush djersën e tij. Kurrsesi me fitue nja dy-tre lekë». Kurse heroina e skicës «A do qymyr zotni?», për të shitur qymyrin që e ka nxjerrë në treg, për t'i dërguar bukë familjes së saj të uritur në fshat, duhet të shesë më parë veten.

Migjeni ka paraqitur me forcë të veçantë artistike indiferentizmin dhe qëndrimin çnjerëzor të shoqërisë së kohës ndaj fatit të njerëzve të varfër. Shoqëria egoiste e të privilegjuarve hidhte pa mëshirë në humnerën e jetës të varfërit, pasi kishte shfrytëzuar egërsisht djersën dhe rininë e tyre. Nuk ishin të pakët ata të varfër që shtrëngoheshin nga nevoja të mirrnin rrugën e lypësisë, të kimit dhe të vagabondazhit. Të braktisur nga shoqëria, ata endeshin në jetë, duke kërkuar shumë pak, sa për të mos vdekur urie dhe mirrnin si shpërblim indiferentizmin, si hero i skicës «Zoti të dhashtë» ose, çka

është më keq, fitojnë një shuplakë therëse, si djaloshi i skicës «Një refren i qytetit tom».

Duke pasqyruar skamjen e madhe, brenat dhe të zitë që hiqin shtresat e ulta shoqërore, Migjeni i shikonte këto si pasoja të pabarazisë dhe të padrejtësisë shoqërore që sundonte në shoqëri. Të papunët, lypësit, gratë e përdalura, të gjithë këta njerëz, i bëri të tillë shoqëria, kushtet e jetës, të cilat i shtynin në rrugën e vesit dhe të krimimit. Varfërinë e masave të shtypura ai ja kundërvë klasave të kamura, të cilat mbanin në dorë të drejtën për lumturi dhe për jetë të mirë. Ironia e shkrimtarit zbulon kontrastin e madh në mes të lukstit të të pasurve dhe jetës të uritur të shumicës së popullit. Kënaqësia e të privilegjuarve nga jeta merr shpesh forma mizore dhe të egra. Objekt i tekave të tyre bëhen të varfërit, të cilët për një lëmoshë shtrëngohen të durojnë gjithfarë fyerjesh dhe poshtërimesh.

Duke e vendosur problemin e gjendjes së shtypur dhe të mjerë të masave popullore në qendër të vëmendjes së mendimit shoqëror dhe artistik, Migjeni i dha një shtytje të ndjeshme zhvillimit të letërsisë përparimtare, e cila në sajë të veprës së tij u bë më sociale nga problematika dhe më kritike për nga fryma. Ai ndihmoi në afirmimin e realizmit kritik në letërsinë shqiptare.

Jeta e mundimshme dhe plot brenge e vegjëlisë tërhoqi vëmendjen edhe të një varg talentesh të reja, që hynë në jetën letrare në vitet 30. Në mjaft vepra të tyre letrarët e rinj përparimtarë paraqesin fakte dhe ngjarje që zbulojnë thelbin social të realitetit. Kështu, në skicat dhe vjershat e P. Markos («Lot' i parë», «Dëshpërim», «Sëmurë rrugëve» etj.) përshkruhet jeta e rëndë e shtresave të ulta shoqërore, jepet pamja e trishtuar dhe e pajetë e fshatit, dramati dhe dhimbshme të njerëzve, që merrnin rrugën e hidhur të kurbetit sepse nuk i mbante me bukë toka. Për njerëzit e varfër, për vuajtjet dhe mungesat e jetës së tyre, flasin edhe autorët e tjerë si A. Çaçi («Hamallit», «Thërrime», «Bujku» etj.), Dh. S. Shuteriqi («Duertë», «Vdekja e peshkatarit»), Sh. Musaraj («Mali i motrës», «Bujku i Hanko Halles»).

Në radhët e letërsisë përparimtare kishte edhe një grup shkrimtarësh demokratë si N. Bulka, H. Stërmilli, S. Spasse etj., të cilët pasqyruan në veprat e tyre në frymë kritike format e vjetra të organizimit të jetës familjare dhe shoqërore, shpërdorimet dhe mashtrimet në administratën e regjimit antipopullor, rolin reaksionar të artit dhe të letërsisë çifligaro-borgjeze etj.

Sikur t'i hidhnim një shikim tërësor procesit historiko-letrar në vitet 30, do të vinim re se kryesore në të ishte zhvillimi në vijë ngjitetëse i letërsisë përparimtare. Por megjithë hapat e rëndësishme që bëri në rrugën e vet, rryma përparimtare nuk arriti të konsolidohet në shkallën e duhur. Zhvillimi i saj u bë në rethanat, kur në jetën letrare ishin përhapur lloj-lloj konceptesh idealiste mbi artin dhe ndikime nga më të ndryshmet, duke nisur nga ato të një sentimentalizmi e romantizmi të sëmurë, bajat, që i kishte ikur koha e deri në ato dekadente. Krahas këtyre, takoheshin edhe vepra me frymë pesimiste dhe nihiliste.

Në zhvillimin e letërsisë përparimtare u shpreh edhe dobësia e përgjithshme e lëvizjes demokratike, mungesa e një lëvizje mendore të organizuar. Kësaj i duhen shtuar edhe pengesat e censurës së regjimit të Zogut, i cili mbyste me egërsi çdo shfaqje të mendimit

të lirë si dhe lufta e tërbuar që kampi i letërsisë reaksionare antipopullore zhvillonte kundër autorëve përparimtarë.

Si rrjedhim i këtyre kushteve letrare dhe politiko-shoqërore, forcimi i letërsisë përparimtare u bë me ngadalë dhe pa stabilitet të brendshëm. Shkrimtarët përparimtarë nuk i shpëtuan ndikimeve të huaja; jo rrallë në veprat e tyre depërtuan motive të pesimizmit dhe të nihilizmit. Më të theksuara shfaqjet e huaja ideore ishin në krijimet e poetëve të rinj. Një pjesë e konsiderueshme e shkrimeve të tyre përshkoheshin nga fryma e dëshpërimit dhe e deluzionimit nga jeta.

E shof jetën, zemër mekë:  
dit'e shendit shpejt u shuen!  
Si e gjith jeta shpirti m'vuen!

— pohon Dh. S. Shuteriqi në poezinë «Vjeshtë». I deluzionuar në aspiratat e tij të dikurshme, poeti nuk gjen prehje edhe kur, për t'u larguar nga realiteti i zyrtë, ja thur këngën e vet «Bukurisë», të kuptuar në mënyrë abstrakte («Inspiration»). Deluzioni nga jeta përshkon edhe vjershat «Dy të pabesët» dhe «Mos shkoni, o ditë». Poeti kujton me hidhërim çastet e lumtura që ranë në humnerat e shpirtit të tij, duke ja lëshuar vendin një nate të zezë. Bashkë me gëzimet e dikurshme ai humbi besimin në mundësitë e dashurisë së lumtur. Edhe vjershën «Kur thyhet lundra» të Sh. Musarajt e përshkon fryma e dëshpërimit të pafund. Poeti e krahason veten me lundërtarin që rropatet mbi copat e lundrës së thyer në mes të dallgëve të detit të egërsuar. Ai është «dritëshuar», «shok i lundërtarit të shuar», që endet «mes valësh pa fanar». Në vjershën «Lot» poeti e ndjen veten të pafuqishëm përpara jetës, e cila i ngjall në zemër frikë dhe pesimizëm. Kurse në poezinë «Njëj shoku» autori pohon me hidhërim: «Jetoj në rërë shkretëtije // ku etjen shoj me lot». Në shumë vjersha të talenteve të reja shfaqet si hero një i ri i pikëlluar, që e ndjen veten të vetmuar në botë. Në poezinë e A. Çaçit «Qava... dhe qava» heroi qan në vetmi, i braktisur nga shokët. Një ankim ndaj jetës është edhe vjersha «Gëzim i kotë» i Dh. S. Shuteriqit. Heroi aspiron «të shuej etjen e fellë për dritë të shueme», por edhe kjo është për të një «gëzim i kotë».

Jo rrallë në krijimet e të rijve kumboi edhe motivi i lodhjes nga jeta, i dëshirës për qetësi. I mërzhitur nga realiteti shoqëror i kohës heroi synon të arratiset në një botë iluzore. Heroi lirik i vjershës «Lot në vetëmi» të Sh. Musarajt kërkon të largohet jo vetëm nga ambjenti që e rrethon, por në përgjithësi nga shoqëria, duke njohur si realitet vetëm ëndërrën e vet. Kjo frymë dëshmonte për faktin se autorët e rinj nuk e kishin të qartë perspektivën dhe nuk shihnin në jetë forcën që do ta rregullonte gjendjen.

Kjo gjendje ishte në letërsinë përparimtare në fund të viteve 30.

Pushtimi fashist e thelloi më tej frymën e pesimizmit dhe të dëshpërimit në radhët e shkrimtarëve përparimtarë. Këtë frymë e shtoi edhe më tepër politika e italianizimit dhe e fashistizimit të jetës mendore, që kishte si qëllim zhdukjen e gjuhës dhe të kulturës kombëtare.

Për mungesën e perspektivës dhe të shpresës që kishte përfshirë shkrimtarët përparimtarë në këtë kohë, flet edhe përmbledhja me

vjersha dhe skica «Antologji» (vëll. I, 1940, vëll. II, 1941), që u botua me inisiativën e letrarëve të rinj si përgjigje kundër qëllimeve asimiluese të pushtuesve fashistë. Ky botim u formua nga shkrime të botuara në vitet '30 në organe të ndryshme, për shumicën e të cilave ishin karakteristike motivet e dëshpërimit dhe deluzionimit nga jeta. Kjo frymë përshkon edhe disa krijime poetike, që u shkruan fill pas pushtimit fashist.

Tronditja që shkaktoi pushtimi fashist solli me vete nga ana tjetër prishjen e unitetit të forcave progresive letrare, që lindi vetvetiu në vitet 30. Një palë, duke mos patur besim në masat e popullit, e shikonin me pesimizëm të ardhmen. Sipas tyre, nuk i dihej fundi zgjedhës në të cilën hyri Shqipëria pas 7 prillit 1939. Në këto rrethana detyra e shkrimtarëve ishte mbajtja gjallë e gjuhës si shenjë e kombësisë, përmes botimit të veprave letrare, qoftë edhe në organet letrare, që nxirte administrata e pushtimit fashist. Kjo pozitë i çoi këta shkrimtarë në qorrsockak. Krijimet e tyre gjatë kësaj periudhe ishin larg jetës së popullit dhe detyrave të reja që i shtronte letërsisë shqiptare situata e re historike në të cilën kishte hyrë vendi pas 7 prillit. Përsëritja e vetvetes, rrahja e temave, që i kishin prekur më parë, si i temës së dashurisë, zakonisht e trajtuar në frymën e një sentimentalizmi bajat, i temës së kurbetit, i zakoneve prapanike dhe konservatore në jetën familjare — ja ç'e karakterizonte krijimtarinë e këtyre letrarëve.

Me një fjalë, pas pushtimit fashist letërsia shqiptare u gjend përkohësisht në një rrugë pa krye; ajo e humbi për një çast perspektivën e vet.

Lufta nacionalçlirimtare, si ngjarje e madhe historike që vuri në lëvizje gjithë jetën e vendit, e shpëtoi letërsinë nga rreziku i varfërimit dhe i rënjes së mëtejshme. Ashtu si gjithë forcave të shëndosha të vendit, lëvizja çlirimtare e masave popullore u ndihmoi shkrimtarëve ta shikojnë realitetin në perspektivë të gjërë historike. Në përvojën e rezultateve të para të qëndresës masive antifashiste, shkrimtarët patriotë e kuptuan se kësaj radhe, duke u ngritur kundër zgjedhës së huaj dhe klasave të vjetra sunduese, populli shqiptar u vu në rrugën e shpëtimit të tij të vërtetë, se fitorja e luftës çlirimtare antifashiste e udhëhequr nga Partia Komuniste, do të hapte një epokë të re në zhvillimin historik të vendit. Shkrimtarët përparimtarë e fituan besimin në jetë, sepse panë forcën kryesore të transformimit të gjendjes — masat popullore të pajisura me një vetëdijë të lartë politike. Ngjarjet dhe faktet e luftës së përditshme i bindën ata për rolin krijues aktiv të masave popullore, për gjërësinë dhe karakterin e pashtershëm të energjiye të tyre revolucionare, për marshimin e sigurtë të lëvizjes revolucionare çlirimtare drejt fitores mbi armiqet.

Kështu Lufta nacionalçlirimtare, hapi rrugë të reja për zhvillimin e letërsisë. Në luftën për çlirimin e vendit lindi dhe u rrit një letërsi e re, parimet ideore dhe estetike të së cilës u formuan nën ndikimin e luftës revolucionare të masave, e cila u dha shkrimtarëve bazë të re ideore, tema dhe heronj të rinj. Nevoja për t'u bërë jehonë ngjarjeve të përditshme të luftës dhe akteve heroike që kryen njerëzit në përleshje me armikun, nxiti zhvillimin e gjinive agjitative dhe publicistike. Në radhë të parë, mori zhvillim poezia, e cila kishte mundësi për t'iu përgjegjur në mënyrë më operative kër-

kesave të kohës. Këngët revolucionare patriotike, hymnet dhe marshet partizane, këngët kushtuar dëshmorëve të rënë në luftë, vjersha dhe poema satirike ishin gjinitë që morën më tepër përhapje në këtë periudhë. Proza e kësaj periudhe u përfaqësua nga gjinitë e shkurtëra: reportazhi, skica, artikulli propagandistik, fejttoni dhe pamflet politik.

Pionierë të letërsisë së re u bënë Sh. Musaraj, A. Çaçi, A. Varfi, Dh. S. Shuteriqi, të cilët e morën shpejt veten dhe e vunë talentin e tyre në shërbim të luftës çlirimtare antifashiste. Pothuajse të gjithë këta letrarë zhvilluan në vitet e luftës një punë të frytshme si propagandistë partie, si drejtues ose bashkëpunëtorë aktivë të organeve të shtypit ilegal. Puna e tyre letrare shkoi doradorës me këtë veprimtari politike propagandistike, shpeshherë duke e marrë lëndën nga problemet që dilnin në këtë fushë.

Vitet e luftës shënuan një fazë të rëndësishme në krijimtarinë e Sh. Musarajt. Lufta nacionalçlirimtare e bëri veprën e tij më aktive dhe luftarake, duke e ushqyer me një brendi të re. Musaraj e shfaqti veten në këtë periudhë si publicist i talentuar dhe i palodhur. Me krijimin e Partisë, Musaraj mori pjesë në ngritjen e shtypit ilegal të lëvizjes, bashkëpunoi në «Zërin e popullit» dhe për një kohë të gjatë ishte ndër drejtuesit e organit të Rinisë antifashiste shqiptare «Kushtrimi i lirisë».

Në artikujt dhe fejttonet e veta, Sh. Musaraj fshikullon ashpër propagandën e armikut, e cila bënte çmos të fshehë fytyrën dhe qëllimet e vërteta të fashizmit italian. Duke përdorur gjerësisht figura dhe shprehje frazeologjike nga e folura e përditshme, autori i çorri maskën pushtesve të huaj dhe tregon, se cilët janë këta. Fashizmin shkrimtari e quan «qelbësirë të shekullit XX». Duke theksuar se gjatë luftës së dytë botërore fashizmit i doli boja dhe njerëzit kudo në Evropë e kuptuan shpejt se ç'përfaqëson ai. Sh. Musaraj shkruante, se fashizmit «as qentë s'i afrohen, jo njerëzit». Shkrimtari zbuloi parrullat mashtruese të propagandës armike dhe nxori në shesh fytyrën e vërtetë të fashizmit si armik të Shqipërisë e të popullit shqiptar. Në «Mizoritë e fashizmit në Pezë», «Armiku s'ngopet me gjak», «Në Pezë armiqtë hanë dru», «Marifetet e fashizmit» etj., autori flet me urrejtje dhe me zemërim për djegjet dhe plaçkitjet e trupave fashiste në fshatrat e Pezës dhe të krahinës së Kosovës, për mizoritë e tyre kundër popullsisë së paarmatosur, stigmatizon me forcë fytyrën prej gjakpirësi të fashizmit. «Armiku — shkruante autori — e ndjen thellë dackën e madhe që pësoi në Stalingrad... dhe po nxitohet të mbushë radhët e boshatisura me njerëz bote..., po nuk i ze syri asnjë që t'i rrëmbejë armët dhe t'i vejë në ndihmë fashizmit. Dhe atëhere ç'ngjet? Ajo që ngjet zakonisht me bishën e plagosur. Një natë të tmerrëshme dimri bisha fashiste armatos me armët e veta disa qindra mercenarë dhe i lëshon atje ku rezistenca është më e vogël»<sup>5</sup>.

Gjithë përbuzje dhe neveri flet autori për veglat e fashizmit, të cilat i quan «gala që mbajnë kombësi shqiptare». Në artikujt «Zëri i Vlorës», «Dy fjalë Mustafa Krujës», «Mustafa Kruja mësheh diellin me shoshë» etj., autori zbulon fytyrën antikombëtare dhe reacionare të agjentit të vjetër të fashizmit italian. Këtë njeri autori

5) Sh. Musaraj, *Marifete të fashizmit*, «Kushtrimi i lirisë», 1943, prill, nr. 2, f. 15.

e cilëson me epitete që nxjerrin qartë në shesh thelbin e jetës dhe të veprës së tij të zezë: «gogol i ndyrë», «kryepërgjegjës i mijra krimeve në kurriz të popullit shqiptar» etj.

Musaraj zotëronte në mënyrë të përsosur humorin dhe sarkazmën e popullit. Shkrimet e tij të luftës janë të mbushur me fjalë dhe shprehje humoristike nga e folura e përditshme e njerëzve të thjeshtë. Me to ai godet ashpër pseudopatriotët, politikanët e vjetër profesionistë, që ishin mësuar ta mbanin veten si «prijsa» të popullit. Këta njerëz, të cilët thonin se populli shqiptar mund ta fitojë lirinë e vet edhe pa gjak, por vetëm me dallavera, me ca kompromise «biçimi», shkrimtari i quan «qullashë të pallogjikë», «qole të bindur të fashizmit», «kapedanë të kohës», që mundohen ta mbajnë veten për «nacionalista me ferman» («Që thua ti...», «Një lloj njerëzish», «Edhe një takëm të sëmurë» etj.). Në artikullin «Kollona e pestë po i tepëron gjynahet» shkrimtari thotë se parullat e tyre e kanë burim në kollona e V dhe se këta njerëz në këtë mënyrë përpiqen të pengojnë popullin të kuptojë fashizmin dhe të fitojë me duart e veta lirinë dhe pavarësisë e humbur. «...Populli ynë — thuhet në këtë artikull — s'ka më pse t'u vari torbën kapadaive të kollonës së pestë, që po ngjiret së ndjelli andej-këndej parrulla dekurajonjëse, parrulla frike, parrulla që fundi fundi s'kanë tjetër burim përveç atij të fashizmit dinak».<sup>6</sup>

Një vend të rëndësishëm, jo vetëm në publicistikën e Sh. Musarajt, por në të gjithë letërsinë e Luftës nacionalçlirimtare, zë pamfletit «Dje dhe sot». Kjo vepër u shkrua në janar të vitit 1944, në kohën kur i gjithë reaksioni, i grumbulluar dhe i drejtuar nga Gestapo, çirrej, se Lufta nacionalçlirimtare ishte në dëm të Shqipërisë, se gjermanët nuk kanë ardhur «si okupatorë» dhe se «nuk do të përzihen aspak në punët e brendshme të vendit». Qëllimi i tyre ishte të ngjallnin hutim dhe konfuzion në popull, ta përçanin atë dhe ta largonin nga lufta kundër pushtuesve hitlerianë. Autori demaskon manevrat e tyre djallëzore, tregon se kush janë njerëzit që bashkëpunojnë me gjermanët kundër popullit shqiptar. «Kur kapitulloi Italia fashiste, tradhëtarët e atdheut, «myflizët», shkruante autori, u vërsulën të shpallin independencën që po i falte Adolf Hitleri». Shkrimtari jep një karakteristikë të goditur të kampit të armiqve të popullit, që u vunë në shërbim të padronit të ri. «Tani shtjehen si patriotë — shkruante Sh. Musaraj — ata që s'kishin çarë ndonjëherë kokën për fatin e atdheut», mbeturinat e fashizmit italian, që «kishin fshehur në shtëpitë e tyre këmishat e zeza» «duaxhit e çmëndur të nazizmit» që komentonin dikur me entuziazëm nëpër sallat e kafeneve «komunikatat e bujshme të Wermachtit», të cilët thonë se «është detyra kombëtare, që i shtrëngon t'i heqin kapellon ushtrisë gjermane» dhe «Balli Kombëtar, daullja, që mbante avazin në orkestrën e tradhëtarëve». Me gjuhë të mprehtë, plot figura dhe shprehje të gjalla, autori zbulonte qëllimet e vërteta të fushatës demagogjike të shpërthyer nga veglat e Komandës gjermane dhe organizatat tradhëtare, të vëna në shërbim të Gestapos.

Si satirik i mprehtë Musaraj e shfaqti veten edhe në poezi. «Epopeja e

6) Sh. Musaraj, *Kollona e pestë po i tepëron gjynahet*, «Zëri i popullit» 1943, shkurt, Nr. 13-14, f. 9.

Ballit Kombëtar» — një nga veprat poetike më popullore në periudhën e luftës — është një demaskim i fortë dhe i goditur i nacionalistëve borgjezë, i këtyre përfaqësueve politikë të klasave të vjetra sunduese, të cilët bënë çmos për të shkatërruar Luftën nacionalçlirimtare. Duke përdorur gjërësisht shprehjet dhe figurat e satirës popullore dhe duke shfrytëzuar ligjërimin enfatik që karakterizonte ambientet politike reaksionare, nga të cilat rridhnin edhe ballistët, Musaraj krijoi kuadro plot humor popullor dhe me shprehje tallëse nga veprimtaria e ballistëve pas kapitullimit të Italisë fashiste e deri në çlirimin e vendit. Poeti nuk i rreshtet elementëve konkretë të jetës, imtësirave reale, të cilat krijojnë një tablo mjaft të gjallë të veprimtarisë së ballistëve si njerëz të dënuar për t'u zhdukur nga historia.

Me qesëndi therëse i përshkruan Musaraj orvatjet e ballistëve për ta shitur veten si patriotë, sikur gjoja gjithnjë u ka qarë zemra për Shqipërinë. Duke parodizuar me mjeshtri tonin enfatik dhe frazat pseudopatriotike të krerëve të Ballit kombëtar, autori ka arritur fort bukur të vërë në lojë falsitetin e parrullave të ballistëve:

Flet Ali beu  
Luft' për Atdhenë!  
Se sot Atdheu  
Pret shumë nga ne.  
Na vlon ndër dejë  
Gjak shqipëtar  
S'durojmë kurrë  
Zgjedhë barbari.

«Epopeja e Ballit Kombëtar» ishte një vepër shumë aktuale nga pikëpamja politike. Për këtë dëshmon edhe popullariteti i saj në vitet e luftës. Vepra u shtyp në tipografi në 2500 kopje; tirazh ky i madh për atë kohë, sidomos po të marrim parasysh jetën ilegale që bënte letërsia e re.

Musaraj është autor edhe i një varg skicash dhe përshkrimesh, që u dukën në faqen e «Kushtrimit të lirisë». Në këto krijime autori synoi të fiksojë lindjen e elementeve të reja në psikologjinë e përfaqësuesve të vegjëlisë, të vizatojë figurën e njeriut që lëvizja revolucionare popullore e ngriti në një shkallë më të lartë, duke e pajisur me ndërgjegje politike («Punra pa lezet», «Të dashur djem», «Ne dhe ata» etj.). Në «Djemt e fshatit» Musaraj rrëfen për zgjimin e masave popullore nën veprimin e luftës çlirimtare antifashiste. Autorin e gëzon çlirimi i njerëzve nga rutina e jetës së vjetër, dukja në vetëdijen e tyre të ndjenjave të reja. «Milicët e xhandarët venë e vinë, Kërkojnë kryengritësit. Po kush ua var trasten. Kryengritës jemi të tërë nashti. S'ka më ujdira me armiq. E kemi kuptuar tej për tej, se ku na pikon shtëpija. Dijmë ta ndajmë të zezën nga e bardha. E varfëra unë, sa e humbur kam qenë»,<sup>7</sup> — janë fjalët e një gruaje plakë labe, të cilat autori i citon me simpati. Në skicat e Musarajt dalin të vizatuara lehtë figurat e njerëzve të thjeshtë të popullit, të fshatarëve dhe të partizanëve, del shpirti patriotik dhe vendosmëria e tyre në luftë kundër fashizmit dhe tradhtarëve të vendit.

7) Sh. Musaraj, *Djemt e fshatit*, «Kushtrimi i lirisë», 1943, mars, Nr. 8, f. 14.

Sh. Musaraj shkroi edhe artikuj kushtuar problemeve të letërsisë së re. («Për literaturën tonë», «Për artin tonë», «Ejani në vete»). Problemi i rëndësisë shoqërore të artit, i pjesëmarrjes së tij në lëvizjen nacionalçlirimtare, i demaskimit të orvatjeve të administratës së pushtuesve, për të mbajtur larg qëndresës popullore shkrimtarët dhe artistët shqiptarë, ishin në qendër të vëmendjes së autorit. «Artistët e vërtetë — shkruante asokohe Musaraj — sot nuk mund të mos jenë kryengritës bashkë me popullin që i rrethon. Dhe populli kupton vetëm atë që ecën bashkë me turmën. Populli do artin e tij, që ja di hallet, ashtu si artisti i mirë e do popullin. Por kjo nuk do të thotë që artisti t'i rrijë në bisht popullit. Artisti e ka si detyrë, duhet ta ndjenjë si detyrë se ai duhet ta zhvillojë sa më shumë popullin, ta ngrerë sa më lartë...»<sup>8</sup>

Autor tjetër, krijimtaria e të cilit shënon një rritje të mëtejshme në këtë periudhë, është A. Çaçi. Shumë vjersha të Çaçit në vitet '30 flasin me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për brengat e veçjelisë, për jetën plot mungesa të njerëzve të punës. Edhe në krijimet që shkroi në vitet e luftës, Çaçi u mbështet në mjetet artistike, me të cilat ai u bë i njohur në botën letrare shqiptare. Poezitë e tij me motiv nga lufta, duke ruajtur thjeshtësinë dhe qartësinë e mëparshme, përshkohen nga patosi heroik i kohës. Një nga krijimet e njohura të Çaçit është vjersha «Syri i nënës». Është historia e qëndrimit burror të një nëne partizane. Kur djali i vetëm që kishte, ra për liri, ajo e fshehu thellë në gji dhembjen dhe trokiti derë më derë, duke grishur njerëzit në luftë kundër të huajit. Çaçi e jep figurën e heroinës me ton romantik.

.....  
një sy që e pata nuk e kam,  
ai m'u shua si një re,  
e pashë që shkoi si rrufe,  
tani kam bij' e bija shumë,  
një popull ngjeshur me liri.

Në frymën e poezisë romantike janë shkruar edhe vjershat «Po duket majë malit», «Partizani i popullit», «Mbi një varr», në të cilat gjeti shprehje atmosfera patriotike e kohës.

Krahas këtyre vjershave A. Çaçi shkroi edhe një varg poezish patetike revolucionare. («Rinia shqiptare», «Po ngrihet lartë Shqipëria», «Përpara në luftë» etj.). Në vjershën «Rinia shqiptare» poeti shprehu ngazëllimin e vet për shpirtin luftarak dhe vendosmërinë e rinisë anti-fashiste në luftë për çlirimin e atdheut.

Patosi burror përshkon edhe ato poezi, të cilat Çaçi ua kushton dëshmorëve që ranë në përpjekje me armiqtë. Humbja e shokëve e ngren më lart vullnetin e popullit për luftë; vendin e të rënëve e zënë qindra të tjerë, që ngrihen për të çuar deri në fund veprën e tyre. («Kujtimit të martirit komunist Ali Demi», «Ngrehu Margaritë»).

Ndryshime të rëndësishme pësoi edhe poezia e Dh. S. Shuteriqit, i cili në vitet 30 ishte prekur më tepër se të tjerët nga ndikimet moderniste. Lufta e popullit për çlirimin e vet kombëtar dhe shoqëror solli në krijimtarinë poetike të Shuteriqit frymën e gjallë të jetës, problemet dhe shqetësimet e epokës. Në këtë periudhë Shuteriqi shkroi një

8) Sh. Musaraj, *Për artin tonë*, «Kushtrimi i lirisë», 1943, gusht-shtator, Nr. 1-2.

sërë veprash poetike, nga të cilat më e rëndësishmja është «O Ptoleme» (1944). Në këtë poemë me mjete ekspresive patetike poeti krijon figurën fisnike të të riut, që dha jetën për çeshtjen e shtrenjtë të çlirimit të atdheut. Megjithëse e shkruar si vajtim për humbjen e shokut të afërt, vepra ka një kumbim më të gjerë. Elementi intim, vetjak largohet mënjanë dhe në plan të parë dalin probleme me rëndësi të përgjithshme. Patosin e veprës e formon mbrojtja e flaktë e idealeve dhe e qëllimeve të lëvizjes nacionalçlirimtare. Me indinjatë të thellë shfren poeti kundër armiqve, veçanërisht kundër intelektualëve pseudopatriotë, të cilët pasi tradhëtuan traditat e Rilindjes Kombëtare, orvaten të njohtosin figurën e pastër morale të rinisë, e cila po e dëshmonte me jetën e vet devotshmërinë ndaj atdheut. Lufta për çlirimin e Shqipërisë zbuloi fytyrën e vërtetë të këtyre njerëzve që e mbanin veten si «elita» e kombit. Kur liria dhe pavarësia e vendit u zhduk dhe nga çdo njeri i ndershëm kërkohet që të përmbushej detyra ndaj atdheut, intelektualët nacionalistë borgjezë e treguan veten ashtu siç ishin, patriotë të rremë, të cilët interesat egoiste të klasës i vunë mbi lirinë e atdheut.

Siç shihet, idea e veprës ishte e rëndësishme, por asociacionet e largëta, të folurit me aluzione të errëta, mendimi i këputur, fragmentar etj. e penguan autorin të jetë i qartë dhe i kuptueshëm.

Krahas veprës së Musarajt, Çaçit, Shuteriqit etj. në fondin e letërsisë së Luftës nacionalçlirimtare hyjnë edhe këngët e vjershat e F. Gjatës, Ll. Siliqit, K. Jakovës etj., të cilët nisën rrugën krijuese dhe u formuan si shkrimtarë në vitet e qëndresës popullore antifashiste.

Krijimtaria e autorëve të rinj u zhvillua në shtratin e poezisë romantiko-revolucionare, e cila formoi tendencën kryesore në zhvillimin e poezisë së luftës. F. Gjata hyri në letërsi me këngët, ku gjeti pasqyrim entuziazmi luftarak me të cilën jetonte rinia shqiptare në atë periudhë. Megjithëse krijimet e Gjatës janë këngë të ndërtuara mbi intonacione agjitative dhe thirrëse, prap mund të flasim për një hero të ri i cili gjeti mishërim në to. Heroi lirik i këngëve të Gjatës shpreh në karakterin e vet tiparet thelbësore të rinisë që i vlonin në zemër ndjenja të vrullshme për liri si dhe etja për akte heroike.

I rrëmbyer nga patosi i luftës për liri, hero i grish të gjithë rininë të rrëmbejë armët, sepse çlirimi i atdheut nga pushtuesit e huaj është detyra e shenjtë e çdo të riu, që i dhimbset Shqipëria («Kushtrimi»).

Kush ka zemër shqiptari,  
del sot malit për liri,

Në «Këngën e rinisë», «Ato maja rrypa-rrypa» etj., ndjehet frymëmarrja e gjallë e rinisë antifashiste, aspirata e saj e papërmbajtur për të shporrë të huajin nga trualli shqiptar, besimi i patundur në fitoren mbi armiqtë. Këtë gjendje shpirtërore, karakteristike për kohën, Gjata e përshkoi me mjetet e figurat heroiko-romantike, që shquanin këngët patriotike të periudhës së Rilindjes Kombëtare:

Rini, rini, përpara ti!  
Si djelli shkrep e vetëti.  
Si zjarr rrufe përpara shko  
Për vatër e nder rini lufto!

Por krahasimet dhe ngjyrat e ndezura, të cilat në ndonjë rast tjetër do të dukeshin si klishe, në atmosferën e entuziazmit patriotik, u perceptuan si diçka e freskët, të mbushura me emocione të gjalla.

Krahas kësaj, duhet thënë, se heroi i këngëve të Gjatës është i njëanshëm; karakteri i tij del vetëm në qëndrimin e tij ndaj luftës për liri. Autori nuk arriti të krijojë figurën e plotë dhe të gjithanshme të pjesëmarrësit të lëvizjes çlirimtare popullore. Kësaj të metë, Gjata nuk ju shmang edhe atëhere, kur karakterin e luftëtarit të ri e dha jo në përmjet figurës së heroit lirik, por me anë të mjeteve epike. Në këngën «Plaku dhe i riu» autori vuri përballë njeri-tjetrit, përfaqësuesin e brezit të luftëtarëve të vjetër, që me gjakun e tyre siguruan më 1912 pavarësinë e Shqipërisë, dhe të riun, që i vlon në zemër ndjenja e flaktë patriotike. Veterani i lëvizjeve çlirimtare i jep uratën për luftë djaloshit, i cili i përgjigjet po me atë ton të ngritur, retorik.

Megjithatë, këngët e Gjatës ishin një fenomen i shënuar në letërsinë e viteve të luftës, sepse pasqyruan veçoritë tipike të kohës. Si pasqyrim i drejtpërdrejtë i ndjenjave të popullit kryengritës, ato u bënë mjaft popullore.

Poet tjetër që e gjeti rrugën e vet në letërsi nën ndikimin e Luftës nacionalçlirimtare ishte Ll. Siliqi. Në vjershat e tij, Siliqi, i këndon me nota të ngritura patetike patriotizmit të popullit, shpirtit të tij liridashës. Patosi i vjershës «S'flen ma Shqipnija» është ngazëllimi për hovin patriotik që ka përfshirë gjithë vendin. Poetin e gëzon qëndrimi burrëror që shfaqin njerëzit përballë armikut. Për qëndresën e papërkulur të popullit, Siliqi flet edhe në poezinë «Pezës», shkruar gjithashtu në një stil patetik — solemn. Veprën e përshkon ideja, se sakrificat që u bënë gjatë luftës do të kujtohen me mirënjohje nga brezat e ardhshëm.

Në poezinë «Heroit Vojo Kushi», shkruar për një ngjarje konkrete, për epopenë e Kodrës së kuqe, Siliqi me ton heroiko-legjendar përshkruan heroizmin e njerëzve në luftë, besnikërinë e tyre ndaj çështjes së çlirimit të Shqipërisë.

«Brankos», «Xhavitit», dhe «Gjikës» janë krijime të një lloji tjetër. Në këto vjersha nëpërmjet emocioneve vetjake të poetit, zbulohet bota e brendshme e të riut patriot, pjesëmarrës i lëvizjes popullore çlirimtare. Poeti sheh tek heronjtë e vet mishërimin e cilësive më të çmuara të popullit. Ata ishin njerëz me dhunti shpirtërore dhe mendore të shquara, me shpirt dhe synime fisnike në jetë. Ata do t'i ipnin shumë këtij vendi dhe këtij populli, por dora gjaksore i vrau në çastin kur forcat e tyre shpirtërore krijuese po shpërthenin me hov.

Në vitet e luftës nisi të shkruajë edhe K. Jakova. Vepra e tij më e përmendur është «Kanga e tre heronjve të Shkodrës», të cilën ja ka kushtuar njerës nga ndeshjet e para me pushtuesit fashistë. Duke shfrytëzuar traditën poetike popullore, Jakova theksoi tiparet karakteristike të komunistëve, devotshmërinë e madhe ndaj idealit dhe gatishmërinë e tyre për të sakrifikuar dhe jetën për çështjen e Partisë.

Çka po thot' Kadija:

— Flak le t'kallet shpija,  
ta mari vesht Shqipnija,  
se na i dalim zot.

\* \* \*

Duke përfunduar, mund të themi, se Lufta nacionalçlirimtare luajti një rol shumë të madh në jetën e letërsisë shqiptare. Ajo u sqaroi shkrimtarëve përparimtarë perspektivën historike, u ngjalli besim në jetë dhe me këtë shpëtoi krijimtarinë e tyre nga varfërimi dhe fishkja që i kanosej. Nën ndikimin e lëvizjes çlirimtare të masave lindi një letërsi e re për nga fryma dhe aspiratat që ushqente, lindi letërsia revolucionare, e cila mori pjesë aktive dhe të drejtpërdrejtë në luftën kundër pushtuesve fashistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Kjo letërsi i edukoi njerëzit me frymën e urrejtjes ndaj armiqve dhe të luftës për çlirimin e vendit. Veprat letrare, të lindura në vitet e qëndresës antifashiste, përshkohen tejndanë nga patosi luftarak revolucionar i kohës. Ato i kënduan heroizmit të popullit, evokuan aktet burrërore të luftëtarëve të lirisë, komunistëve dhe partizanëve, që ranë në ndeshje të babarabarta me armiqtë. Letërsia revolucionare tregoi edhe ndryshimet e reja që ndodhën në ndërgjegjen e masave nën ndikimin e ngjarjeve të luftës, si shfaqjen dhe formimin tek ta të një qëndrimi revolucionar ndaj jetës. Pasqyrimi i elementeve të reja që shfaqen në psikologjinë e njerëzve u shoqërua me stigmatizimin e forcave shoqërore e politike, që pengonin emancipimin shpirtëror e politik të masës, lindjen në ndërgjegjen e saj e ndjenjave dhe aspiratave të reja.

Ndryshe nga letërsia përparimtare e viteve 30, që kishte një ideal pozitiv të vagëlluar, krijimtaria e shkrimtarëve të kësaj periudhe kishte karakter mjaft të qartë partishmërie dhe frymëzohej nga një ideal më i përcaktuar nga ana shoqërore, nga ideali i luftës për vendosjen e një rendi të drejtë shoqëror e politik.

Lëvizja letrare e përfutur nga Lufta nacionalçlirimtare vazhdoi më pak se tre vjet. Por rëndësia e saj është shumë e madhe. Në gjirin e letërsisë së kësaj periudhe u përshenjën ato tendenca dhe elemente të reja ideore dhe artistike, të cilat u zhvilluan dhe u pasuruan më tej nga shkrimtarët e sotëm. Pasqyrimi i jetës nga pikëpamja e popullit kryengritës, heroi i ri pozitiv, partishmëria revolucionare — këto arritje novatore të shkrimtarëve të luftës formuan bazën mbi të cilën u ngrit letërsia e realizmit socialist, e cila po i çon më tej traditat progresive të zhvillimit të mëparshëm letrar.

### R é s u m é

#### LE ROLE DE LA LUTTE DE LIBERATION NATIONALE SUR LE DEVELOPPEMENT DE LA LITTERATURE ALBANAISE

L'auteur traite le rôle joué par la lutte de libération nationale sur le développement de la littérature albanaise. Il aboutit à la conclusion que la lutte du peuple albanais contre les envahisseurs fascistes, en tant qu'événement de grande portée historique, a eu une influence profonde sur le développement des lettres. Elle a entraîné l'apparition de nouveaux éléments, qui ont modifié la direction du processus littéraire.

A argumentation de ces points de vue, l'auteur examine l'état de la littérature dans les années 20-30. Le principal trait du processus historico-littéraire dans cette période est, d'après l'auteur, la formation du courant progressiste dans la littérature. Mais ce processus se développe à des rythmes lents et à grand effort

en raison des circonstances politiques et culturelles défavorables. Dans les années 30 la littérature progressiste avait réalisé des pas, mais sans parvenir à se consolider dûment. A côté des oeuvres à problématique sociale poussée et esprit critique, on rencontre aussi des productions d'esprit pessimiste et même nihiliste.

Cela attestait que les jeunes littérateurs progressistes n'avaient pas claire la perspective et ne voyaient pas dans la vie la force appelée à mettre de l'ordre et brider cet état de choses. L'invasion du pays par les fascistes italiens le 7 avril 1939 a rendu encore plus profond cet esprit. En un mot, après la conquête fasciste, la littérature albanaise s'est trouvée temporairement dans un cul-de-sac. Les écrivains progressistes traversaient à cette époque un état d'égarement et étaient sujets à une dépression idéologique et spirituelle.

La lutte de libération nationale, en tant que grand événement historique qui a mis en mouvement toute la vie du pays, a soustrait la littérature au danger de l'appauvrissement et de la chute ultérieure. Le mouvement de libération nationale des masses populaires a aidé aux hommes de lettres, au même titre qu'à toutes les forces saines du pays, à envisager la réalité dans une ample perspective historique. En présence des premiers résultats de la résistance massive antifasciste, les écrivains patriotes ont compris que cette fois le peuple albanaise, soulevé contre le joug étranger et les anciennes classes au pouvoir, s'était mis sur le chemin de son véritable salut, que le triomphe de la lutte antifasciste de libération nationale, conduite par le Parti communiste, devait ouvrir une nouvelle époque dans le développement historique du pays. Les écrivains progressistes acquièrent ainsi la confiance dans la vie, du fait d'avoir vu la principale force formatrice de la situation: les masses populaires douées d'une haute conscience politique. Les événements et les faits de la lutte quotidienne les ont convaincu du rôle créateur actif des masses populaires, de l'amplitude et du caractère intarissable de leurs énergies révolutionnaires, de la marche certaine du mouvement révolutionnaire de libération vers la victoire sur les ennemis.

C'est ainsi que la lutte de libération nationale a ouvert de nouveaux chemins pour le développement des lettres. C'est en lutte pour la libération du pays que s'est fait jour et qu'a pris de la taille une nouvelle littérature, dont les principes idéologiques et esthétiques ont été formés sous l'influence de la lutte révolutionnaire des masses. C'est celle-ci qui a donné aux hommes de lettres une nouvelle base idéologique, de nouveaux sujets et de nouveaux héros.

Pionniers de ce nouveau mouvement devinrent ainsi Sh. Musaraj, A. Çaçi, A. Varfi, Dh. S. Shuteriqi. Ils se sont repris rapidement et ont mis leur talent au service de la lutte antifasciste de libération. Presque tous ces littérateurs ont déployé, durant les années de la lutte, un travail fécond en tant que propagandistes du parti, de directeurs ou de collaborateurs actifs des organes de la presse illégale. Leur activité littéraire a marché de pair avec cette activité politique de propagande, souvent en puisant leur matière des questions qui surgissaient dans ce domaine.

La littérature révolutionnaire, qui a pris naissance sous l'influence des nouvelles idées a pris une part active et directe dans la lutte contre les envahisseurs fascistes et leurs collaborateurs. Cette littérature a éduqué les gens dans l'esprit de l'abhorration envers les ennemis, en faveur de la lutte de libération du pays. Les productions littéraires, qui ont vu le jour dans les années de la résistance antifasciste, sont empreintes complètement du pathos combattif révolutionnaire du temps. Elles ont chanté à l'héroïsme populaire, ont évoqué les actes de bravoure des combattants de la liberté, des communistes et des partisans tombés dans un heurt inégal avec les ennemis.

La littérature révolutionnaire a illustré aussi les nouveaux changements intervenus dans la conscience des masses populaires sous l'influence des événements

de la guerre, comme la manifestation et la formation chez elles d'une attitude révolutionnaire envers la vie. Le reflet des nouveaux éléments qui se manifestent dans la psychologie des hommes a été associé à la stigmatisation des forces sociales et politiques qui empêchaient l'émancipation spirituelle et politique de la masse, l'apparition dans sa conscience de nouveaux sentiments et de nouvelles aspirations.

A différence de la littérature progressiste des années 30, qui n'avait qu'un idéal positif vague, la création des écrivains de cette période était empreinte à l'évidence de l'esprit du parti et s'inspirait à un idéal plus déterminé au point de vue social. à l'idéal de la lutte pour l'instauration d'un ordre social et politique juste.